



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 3.12.2019, ora 16.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar Komisioni

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i 4 Akteve Normative me fuqinë e ligjit. Konkretisht:

1. Akti Normativ “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “për tatimin mbi vlerën e shtuar në republikën e shqipërisë”, të ndryshuar”
2. Akti Normativ “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”
3. Akti Normativ “Për një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “për sigurimet shoqërore në republikën e shqipërisë”, të ndryshuar”
4. Akti Normativ “Për një shtesë në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Suzana Topi, Krenar Rryçi, Evis Kushi, Arben Elezi, Korab Lita, Xhevit Bushaj, Ervin Bushati, Ylli Shehu, Roland Xhelilaj, Vullnet Sinaj, Artur Roshi, Edlira Hyseni, Anastas Angjeli, Reme Lala, Antoneta Dhima,

Mungojnë:

Senida Mesi, Eljo Hysko, Blerina Gjylameti,

Të ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomise

1. Znj. Anila Denaj, Ministre
2. Znj. Mimoza Dhembli, Drejtoreshe e përgjithshme e Buxhetit,
3. Z. Nikolla Lera, Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit
4. Z. Saimir Mucmataj, Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të

Kuadrit Rregullator

Ministria e Mbrojtjes

1. Z.Petro KOÇI, Zëvendës Ministër i Mbrojtjes
2. Z.Nuri LAKNORI, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Ministria e Brendshme

1. Z. Julian Hodaj, Zv. Minister
2. Znj. Renata Balliu, Pergjegjese e Keshillimit Ligjor dhe Monitorimit te Impaktit te Akteve Rregullatore

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përsëndetje!

Sot kemi shqyrtimin e katër akteve normative me fuqinë e ligjit. Konkretisht aktin normativ “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Aktin normativ “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”.

Aktin normativ “Për një shtesë në ligjin 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar””.

Aktin normativ “Për një shtesë në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat””.

Të gjitha aktet janë në funksion të programit të rindërtimit për të lehtësuar punën e qeverisë, aktorëve që do të rindërtojnë dhe mbi të gjitha jetën e qytetarëve që janë dëmtuar fatkeqësisht nga tërmeti.

Zonja Ministre, unë mendoj të bëjmë një paraqitje koncize për çdo akt. Nëse zoti Roshi u pendua për të folur, do të kalojmë në votim, nëse jo, ai do të flasë dhe ne do ta dëgjojmë me vëmendje, pastaj do të vazhdojmë me procedurën.

Zonja Ministre, fjala për ju. Pra, do t’i marrim një e nga një. Të fillojmë me aktin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

Anila Denaj – Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në përgjigje të shpejtë të fatkeqësisë natyrore të tërmetit që goditi Shqipërinë, Ministria e Financave ka mobilizuar strukturat e saj dhe së bashku me ministrinë e tjera është angazhuar për t'u ardhur në ndihmë të menjëhershme për të zgjidhur problematikat emergjente pas tërmetit. Në kuadër të programit sigurisht që do të vijojë të bëjë të njëjtën qasje produktive.

Në raport, ndryshimet ligjore të buxhetit sigurojnë të drejtën për pension të posaçëm për qytetarët pensionistë, të cilët kanë humbur të afërmit nga tërmeti; të drejtën e trajtimit financiar për të mbijetuarit e familjeve me humbje fatkeqe në njerëz; të drejtën për ndihmë financiare për familjet e të gjitha viktimave, në masën 1 milion lekë dhe të drejtën për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjitha viktimat e këtij tërmeti, gjithashtu dhe të drejtën për bursë në masën 15 000 lekë në muaj për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar, arsimin e mesëm profesional...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po bëj një përmbledhje të të gjitha pikave që janë adresuar dhe konsiderohen si një paketë emergjente në kuadrin e ndryshimeve të bëra. Pra, të mbledhura të gjitha bashkë krijojnë një qasje më të plotë.

Akti normativ “Për disa shtesa në ligjin 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” ka për qëllim përjashtimin nga detyrimi i pagimit mbi vlerën e shtuar të mallrave dhe pajisjeve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake që përdoren si armë, municione apo bazë materiale për luftë dhe që janë projektuar, zhvilluar, prodhuar, montuar apo modifikuar për përdorim ushtarak, përfshirë edhe ato që importohen në emër të Ministrisë së Mbrojtjes. Qëllimi tjetër i këtij akti normativ është edhe përfshirja në përjashtimet nga pagesa e TVSH-së së mjeteve dhe pajisjeve që përdoren për të ndërtuar zonat e prekura nga fatkeqësitë. Këtë përjashtim e kemi kufizuar në rastet dhe afatet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Këto dy elemente janë pjesë e fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe përfaqësojnë një interes publik madhor. Për detajet e pyetjeve zëvendësministri do të japë përgjigje në vijim.

Për sa i takon aktit normativ “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes këtij akti normativ ka mundësuar rritjen e nivelit të njohjes së shpenzimeve të zbritshme nga 3% në 8%, për donacione në mjete monetare të bëra nga biznesi. Ky akt vlen gjithashtu edhe për donacionet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me 8%, aktualisht është 3...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lejoni, po ta lexoni, fjalë e parë e aktit normativ ka një klauzolë që thotë: “Përtej lehtësisë së njohur aktualisht, përveç kufijve të përcaktuar në nenin 5 të ligjit nr 7892 “Për sponsorizimet”, donacionet në mjete monetare mbi nivelin 5% të fitimit para tatimit, të bëra për rastet e shpalljes së fatkeqësisë natyrore brenda afatit të përcaktuar dhe të transferuar në llogarinë e thesarit. Gjithashtu, në rastet kur donacionet financiare, kjo shkon përtej anës financiare, janë në formën e pasurive të paluajtshme, vlerësimi i kontributit mbi nivelin 5% në raport me fitimin përpara tatimit...

Arben Ahmetaj – Ministre më falni, në dijeninë time është 8 %. Të kërkoj ndjesë, por kërkoj të mbani një qëndrim zyrtar është 5 apo 8%?

Anila Denaj – Është 8%.

Arben Ahmetaj – Dakord. Atëherë të shënohet që akti normativ shkon me 8%, unë e kuptoj që është një lapsus i zyrës.

Faleminderit Ministre!

Anila Denaj – Më lejoni të theksoj se nuk ka të bëjë vetëm me vlerën monetare të bëra si donacion, por edhe të gjithë donacionet që janë në formën e pasurive të paluajtshme. Kjo incentivë do të vlejë për periudhën e gjendjes së fatkeqësisë natyrore duke mundësuar mobilizimin e mbështetjes monetare në mënyrë të menjëhershme edhe nga sektori privat.

Për sa i përket aktit normativ “Për disa shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Vazhdoni, zonja Ministre.

Anila Denaj – Ky akt normativ u siguron të drejtën për pension të posaçëm qytetarëve pensionist që kanë humbur të afërmit nga tërmeti. Akti normativ siguron më tej trajtimin financiar të veçantë për të mbijetuarit e familjeve me humbjet më të mëdha në njerëz nga ky tërmet. Këto trajtime sigurohen nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe do të ndiqen me vendime nominale të Këshillit të Ministrave.

Akti për dhurimin e 17 apartamenteve në pronësi të Bashkisë Tiranë për familjet e viktimave të tërmetit të datës 26 nëntor 2019 është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nga Ministria e Brendshme, për shkak të nevojës që lind për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, duke u ardhur në ndihmë familjarëve të

viktimave, të cilët humbën jetën dhe kanë pësuar dëmtime në banesat e tyre, duke i bërë ato të pabanueshme.

Qeveria në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës synon të minimizojë pasojat e tërmetit, duke u siguruar familjarëve të viktimave banesa që do të dhurohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kontrata e dhurimit do të realizohet sipas parashikimeve të Kodit Civil dhe do të nënshkruhet nga kryetarët e bashkive ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për përfaqësuesit e familjeve përfituese të përcaktuar në listën e dërguar nga Komiteti ndërministror i Emergjencave Civile. Shpenzimet procedurale për kryerjen e transaksioneve për dhurimin e pasurisë do të paguhën nga bashkitë, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.

Për sa i takon VKM-së për përkrahjen sociale dhe financiare të familjeve të viktimave të tërmetit të datës 26 nëntor të vitit 2019, e cila është hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është akorduar një ndihmë sociale dhe financiare nga qeveria për familjet e të gjitha viktimave të tërmetit në masën 1 milion lekë. Përmes këtij vendimi do të kujdesemi që të gjitha familjet e viktimave të tërmetit të përfitojnë menjëherë mbulimin e shpenzimeve të varrimit për të gjitha viktimat e këtij tërmeti. Kjo mbështetje sigurohet nga buxheti i shtetit dhe do të ndiqet me vendime nominale të Këshillit të Ministrave.

Për sa i takon vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave”, për vitin shkollor 2019-2020 do të përfitojnë bursë në masën 15 mijë lekë në muaj të gjithë nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, banesat e të cilëve janë shpallur të prishura dhe të pabanueshme në qarqet, si: Tiranë, Durrës dhe Lezhë, nga ky tërmet.

Për çdo pyetje jemi të gatshëm të përgjigjemi.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Ministre, për punën e pareshtur të këtyre ditëve, si dhe stafit tuaj, ndaj me modesti do t’i lutesha komisionit që t’u largohemi qëndrimeve politike. Gjithsesi, unë ju ftoj, më pas se çfarë bëni ju është puna juaj, por është një paketë shumë njerëzore për të ndihmuar qeverinë dhe të gjithë aktorët politikë, mbi të gjitha, qytetarët në këtë moment të vështirë dhe, në qoftë se ka ndonjë pyetje apo ndonjë qëndrim, le ta bëjmë. Ndërkohë, para se të vazhdojmë me qëndrimet apo me pyetjet për sa i përket njohjes së shpenzimeve për rastet e donacioneve, le të korrigjojmë 5%-in në formulimin që ju më keni sjellë.

Zoti Niko, ndiqeni formulimin, që më pas ta konfirmojë zyrtarisht ministrja nëse doni apo nuk doni që ta bëjmë kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam fjalën për atë lapsus të vogël që është bërë në shkrim, pasi aktin normativ, në bazë të Kushtetutës dhe rregullave, nuk mund ta ndryshojmë në komision. Unë besoj se kur është shtypur ky gabim mund të jetë bërë pa dashje, kështu që, ju lutem, na e sillni të korrigjuar, në mënyrë që të mos e vazhdojmë më këtë diskutim.

Dakord, zonja Ministre?

Faleminderit!

Kush ka diskutime apo pyetje?

A keni pyetje ? Patjetër!

Edlira Hyseni – Po filloj me pyetjen e parë dhe po i marr aktet normative kështu siç i listoi edhe ministrja.

Së pari, kam dy pyetje të shkurtra për sa i përket përjashtimit të importimit. Dy raste të përjashtimit të TVSH-së në import ishin: njëra për ushtarakët, pra për sa u takon mallrave dhe pajisjeve për qëllime ushtarake, dhe tjetra për materialet dhe pajisjet që lidhen me gjendjen e jashtëzakonshme, në të cilën jemi aktualisht.

E para thotë “brenda afatit të përcaktuar”, kurse e dyta nuk jep afat. Brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 kuptojmë se cili është afati, pra për sa kohë është gjendja e fatkeqësisë natyrore tek importi, te përjashtimi i parë i TVSH-së. Pra, ky përjashtim është i vlefshëm vetëm për ato mallra dhe pajisje që i takojnë specifikisht këtij qëllimi vetëm brenda afatit të gjendjes së jashtëzakonshme, ndërsa përjashtimi i dytë nga TVSH-ja nuk ka afat. Unë besoj se mbetet përgjithmonë përtej rastit të jashtëzakonshëm. A jam e qartë lidhur me pyetjen për aktin e parë normativ?

(Diskutime pa mikrofon)

Lidhur me aktin e dytë normativ për donacionet që saktësuam, është 8% dhe jam shumë dakord. Kam diçka lidhur me shprehjen: “Donacionet në mjete monetare të transferuara në llogarinë e thesarit”. Po bizneset që duan të bëjnë donacione, të cilat nuk do t’i bëjnë nëpërmjet llogarive të thesarit, por nëpërmjet individëve direkt e të tjerë, a do të vlejë kjo masë, pra ky ndryshim? Pra, a do të njihen si shpenzime të zbritshme për efekt të tatim-fitimit në masën 8%, edhe pse donacionet e tyre monetare nuk kanë kaluar nëpërmjet llogarive të thesarit, por kanë kaluar direkt ose tek individi, te njerëzit në nevojë apo te fondacionet e të tjera? Sepse këtu është shprehur qartë: “...të transferuara në llogarinë e thesarit”. Pra, unë dua të di pse do të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbase unë nuk e kam kuptuar, por është pyetje.

Pyetja e tretë lidhet me apartamentet. Më bëri përshtypje që Tirana e ka të saktësuar numrin e apartamenteve që është 17 dhe shumë mirë që e ka përcaktuar. Bashkia e Durrësit nuk ka ende një numër, nuk e kuantifikon dot se sa mundësi ka për të dhuruar apartamente. Meqënëse Bashkia e Durrësit është më e prekura dhe është bashkia e parë e interesuar për t'u dhënë apartamente familjeve, a ka ajo një numër sasior të apartamenteve që do të vërë në dispozicion, apo që ka mundësi t'i dhurojë?

Pyetja e katërt.

Në dijeninë time, me aq sa unë e kam lexuar aktin normativ, që saktëson vetëm pensionet 13-fish apo 8-fish, ne nuk kemi të specifikuar as bursën 15 mijë lekë, as ato 1 milion lekë që ju thatë. Në aktin normativ, ndoshta është në relacion, nuk referohet as puna e bursës 15 mijë lekë dhe as kontributi 1 milion, por flitet vetëm për një pension 13 –fish apo 8 –fish dhe për asgjë tjetër. Ndoshta në këtë material që unë kam para nuk është, por mund të jetë e shprehur në relacion diçka më gjatë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, keni fjalën.

Më pas fjalën e ka zëvendësministri.

Anila Denaj - Më lejoni të sqaroj çështjen lidhur me donacionet, të cilat kalojnë nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit dhe arsyeja pse është e kufizuar vetëm për këto donacione. Unë mund të them se është një portal i hapur për të gjitha donacionet të çfarëdolloj forme dhe të grupuara në formate të tjera për t'i kanalizuar këto grumbullime fondesh nëpërmjet llogarisë së thesarit të buxhetit të shtetit, që, sigurisht, do të jenë pjesë e një programi, siç është anonçuar, dhe do të orientohet për rindërtimin. Ky program do të ketë si kontekstin financiar, ashtu edhe planet më optimalet të mundshme për të riorganizuar të gjithë jetën pas tërmetit. Në kontekstin e benefitit të dhënë më lart, pra të sponsorizimit për efekt njohjeje të shpenzimeve, do të jenë vetëm për ato që kalojnë nga thesari.

Ndërkohë, lidhur me pyetjen e fundit, unë i lexova të gjitha aktet normative që ne kemi kaluar faktikisht dhe për këtë arsye i raportova pa e ditur se çfarë mund të jenë, por janë të veçanta. Pra, është i veçantë kontributi i dhënë në raport me sigurimet shoqërore shkon diku në masën 60 mijë lekë të rinj për përfutuesit; është e veçantë pjesa e bursës për arsimin dhe është e veçantë pjesa e kontributeve të drejtpërdrejta për familjet.

Ndërkohë, për pjesën e aktit normativ, që ka të bëjë me miradministrimin e mbrojtjes, do të flasë zoti zëvendësministër dhe më pas për apartamentet do të flasë zëvendësministri përkatës.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zoti Koçi.

Petro Koçi - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë, në fakt, pasi ministrja e përfundoi paraqitjen e saj, megjithëse bëri një paraqite ezaauruese, doja të shtoja se efekti i këtij ndryshimi, që përjashton detyrimin e pagimit të TVSH-së për pajisjet, për mallrat dhe mjetet ushtarake do të shtrihet në mënyrë të përhershme. Pra, ka efekt të përhershëm dhe efekti i menjëhershëm ka lidhje me bazën e Kuçovës, që lidhet direkt me zhvillimet e këtij kapaciteti në vitin e ardhshëm. Ndërsa, përjashtimi i dytë, që ka të bëjë me mallrat, pajisjet dhe mjetet, që do të importohen për të përballuar fatkeqësinë natyrore, ka efekt të përkohshëm. Në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, ky ndryshim do të përfundojë edhe efektin e tij. Unë këtë doja të thosha.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Po, ju lutem.

Julian Hodaj - I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Në momentin që qeveria ka hartuar këtë akt normativ, vetëm Bashkia e Tiranës kishte shifra të sakta për disponibilitetin, por, gjithsesi, më e rëndësishme është që ky akt normativ i hap rrugën jo vetëm Bashkisë së Durrësit, Bashkisë së Kurbinit apo Bashkisë së Lezhës, por të gjitha njësive të tjera të qeverisjes vendore që të ndjekin të njëjtën procedurë për sigurimin e pjesës tjetër të apartamenteve.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – A jeni e qartë, zonja deputete?

Faleminderit!

Po, zoti Lita, qëndrimi juaj.

Korab Lita - Faleminderit, zoti kryetar!

I falënderoj të ftuarit!

Fatkeqësi natyrore, si ajo e datës 26, sigurisht që nuk e kemi ne në dorë që t'i ndalojmë, por ne, si pjesë qeverisëse, kemi në dorë që të bashkohemi të gjithë dhe t'i përballojmë ato me shumë sukses dhe për më pak dhimbje për të dëmtuarit. Kështu që, në këtë këndvështrim, unë mendoj se projektet që ka bërë qeveria dhe ka sjellë në ndihmë të asaj

ngjarjeje natyrore, ne do t'i mbështesim, me qëllimi që t'u vijmë më shumë në ndihmë të dëmtuarve dhe situatës në përgjithësi. Nuk është koha tani që të futemi dhe të shikojmë gjëra të vogla, kështu që i mbështes aktet normative.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Lita!

A ka ndonjë qëndrim tjetër?

Po, zoti Angjeli.

Anastas Angjeli – Unë mendoj se aktet normative që kanë ardhur janë të domosdoshëm, janë në kohë dhe janë të dobishëm për situatën që u krijua.

Kam një sugjerim, sa të jetë e mundur, për ato që mund të konsiderohen. U bënë disa vite rresht që për shkak të disa ndryshimeve klimaterike numri i inondatave, i përmytjeve, është rritur. Ndërkaq, për fatin tonë jonë të mirë, kemi dy tërmetet e fundit. Nuk besoj se vetëm me akte të shpejta do të përballojmë situatat e ardhshme, sepse ne nuk e dimë se çfarë mund të ndodhë. Që këtë e tutje ne nuk e dimë nëse do të ketë apo jo përmytje më të mëdha. Ne nuk mund të “falemi” te fondi i kontigjencës, as te fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Unë mendoj se ne duhet të jemi të përgatitur për akte ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë mënyrën e mbështetjes së situatave të krijuara nga këta faktorë, qoftë edhe rregullore, qoftë edhe udhëzime, çfarëdo të jenë, edhe për mënyrën e donimit, edhe për përfitimet apo jo të atyre që donojnë, të brendshëm apo të jashtëm. Pra, ka ardhur koha që këto të rishikohen në funksion të situatave që po krijohen. Faleminderit!

Arben Ahmetaj –Faleminderit, zoti Angjeli!

Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Pa e zgjatur, mbaje shënim, se nuk kam qëndrim politik, thjesht mbështes qëndrimin e zotit Angjeli. Duhet hartuar dhe duhet bërë një plan strategjik ose një përfshirje e menduar mirë për buxhetin e vitit që po vjen. Sigurisht, kjo duhet bërë në përputhje me atë që tha zoti Koçi, që gjërat duhet t'i shikojmë në mënyrë stabile, ashtu sikundër NATO apo hapi që ne ndërmorëm në raport me mjetet luftarake, që vijnë këtu për të hequr përfundimisht TVSH-në. Të tilla duhet të jenë edhe projektligjet për emergjencat. Pra, ne duhet të hartojmë plane të menduara dhe të llogaritura mirë në tri fusha: në fushën e tërmetejeve, përmytjeve dhe zjarreve. Pra, të tria këto duhet të përfshihen në buxhetin e vitit që vjen. Pra, sipas meje, duhet korrigjues buxheti. Për të tjerat më duket e paktë kjo mbështetje. Megjithatë, i mbështesim edhe me këto mundësi që ka qeveria. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Roshi!

Falënderoj edhe opozitën për mbështetjen që u bën akteve!

Ka ndonjë koment apo ndonjë qëndrim tjetër?

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Pa dashur t’ju vonoj...

Arben Ahmetaj – Po vononi votimin, zoti Koçi.

Petro Koçi – Sigurisht, ky është një shqetësim qytetar dhe politik, por para ca kohësh ne kemi kaluar ligjin që emergjencat civile i kthen në agjenci kombëtare të mbrojtjes civile dhe synimi dhe zbatimi i tij është pikërisht zvogëlimi i riskut të fatkeqësive. Në rastin e tërmeteve mendoj se ka dy drejtime ku duhet të punohet: së pari, me standardet e ndërtimit, që duhen të rreptësohen dhe, së dyti, me modernizimin e sistemit të reagimit të emergjencave civile. Në rastin e përmbytjeve, zjarreve dhe thatësirave, sigurisht që mund të merren një sërë masash të tjera dhe kryesisht mund të bazohemi në projekte që mund të kenë përdorim të dyfishtë. Pra, mund të kenë variante dyfishe të shfrytëzimit të këtyre investimeve apo projekteve, që kryesisht burojnë nga pushteti vendor. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zonja Ministre. Edhe ju po vononi votimin.

Anila Denaj – Duke mbështetur atë që tha zoti Fino... Më falni, doja të thosha zoti Angjeli!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju kërkoj ndjesë, por ka një arsye pse e ngatërrova dhe do t’ju them pak më vonë. Është i njëjti debat logjik që ka ndodhur në një komision tjetër, prandaj ndodhi kjo ngatërresë.

Doja të thosha se pushteti vendor ka një fond të caktuar, i cili ndikon në parandalimin e situatave të fatkeqësive natyrore, sidomos për përmbytjet dhe shtretërit e lumenjve. Edhe në komisionet ku u diskutua buxheti u ngrit si çështje nëse është i mjaftueshëm ky fond, që është gati 1 miliard lekë. Së fundi, edhe nga kërkesat e bëra mbas tërmetit, sidomos nga Ministria e Bujqësisë, u soll një propozim për të shtuar disa nevoja për parandalim. Kjo nuk ka të bëjë me fondin e emergjencës dhe për sa kohë ka të bëjë me një fond që shkon për të përmirësuar situatën aty ku vështirësia mund të jetë më e madhe, tek urat, shtretërit e lumenjve, për disa fatkeqësi natyrore, ne konsiderojmë jo vetëm fondin që sot e ka pushteti vendor dhe është i konsiderueshëm, por edhe një fond shtesë.

Në diskutimin që do të bëjmë edhe më tej për zbardhjen nën për nën të buxhetit, mund të jemi të mirëkuptuar që një shtesë, sidomos për adresimet për parandalim, të jetë e nevojshme.

Ne kemi marrë informacionin nga ministria përkatëse se ku duhet të jenë ndërhyrjet dhe do të kërkoj mirëkuptimin tuaj kur t’i aprovon këto ndryshime të buxhetit, që ta shikoni

me këtë objektiv. Ka qenë edhe për parandalim, përtej postreagimit. Është me vend ajo që thoni ju, që rregulloret duhet të jenë të aktivizuara në momentin më të parë kur ndodhin.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Besoj se është një lapsus në drejtshkrim në aktin që i referohet tatimit mbi të ardhurat. Nuk është ndryshim që po bën komisioni, se nuk lejohet të bëhet ndryshim... Asgjëkund nuk bëhet kjo. Akti normativ kalon ose rrëzohet dhe kalon siç sillet, por meqënëse ka gabim në zbardhje, korrigjoheni.

Faleminderit!

Kalojmë në votim.

M'i sillnin një nga një ato...

Votojmë në parim, nen për nen dhe në tërësi.

Vetëm një votim, pa asnjë...?

Faleminderit!

Votojmë aktin normativ nr. 4, datë 30.11.2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Faleminderit edhe opozitës për mbështetjen dhe qartësinë që u bëni qytetarëve dhe indirekt qeverisë, që është 24 orë në detyrë!

Keni përgjegjësi ndaj qytetarëve që përfaqësoni dhe jam i bindur se edhe ata që nuk e kanë votuar qeverinë tonë dhe maxhorancën përsëri ju falënderojnë për mbështetjen që jepni për këta qytetarë dhe indirekt për qeverinë, që të përballojë pasojat e tërmetit.

Akti normativ nr. 6, datë 30.11.2019, “Për dhurimin e apartamenteve familjarëve të viktimave si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019”.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Akti normativ nr.7, datë 30.11.2019, “Për një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Akti normativ nr. 5, datë 30.11.2019, “Për një shtesë në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar””.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit zotërinjve zëvendësministra, si dhe stafit teknik!

Të katërta këto do të kalojnë në seancë pasnesër.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti